



**Në bazë të nenit 11 të Statutit të Kolegjit Universitar "Biznesi" në Prishtinë,
Këshilli i Lartë Mësimor-Shkencor i Kolegjit Universitar "Biznesi" më
14. 07. 2010 miratoi këtë:**

RREGULLORE

PËR POLITIKAT E KOLEGJIT UNIVERSITAR "BIZNESI" PËR RECENSION DHE VLERËSIMIN E PERSONELIT AKADEMIK

Kolegji Universitar "Biznesi" (KU "Biznesi") në kuadër të funksionimit të vet hulumtues bën vlerësimin e stafit akademik, nxit inovacionin, kërkimin, botimin dhe zhvillimin e personelit akademik. Për këtë qëllim hartohet në mënyrë profesionale recensionin nga ekspertet e lëmive. KU "Biznesi" ka themeluar Qendrën për hulumtime shkencore (QHSH) për të kryer punë kërkimore-shkencore.

1. Procesi i recensionit

1.1 Artikujt, librat dhe materialet e tjera të shkruara, të cilat nuk janë të botuara nga shtëpitë e njohura botuese ndërkombëtare për përdorim në veprimtaritë mësimore në KU "Biznesi" do t'i nënshtrohen recensioneve të Komisioneve profesionale shkencore të Qendrës për Hulumtime Shkencore dhe botime në KU "Biznesi".

1.2 Qendra për hulumtime shkencore në KU "BIZNESI" është pjesë e Kolegjit, dhe do të udhëhiqet nga Drejtori i Qendrës për hulumtime shkencore dhe botime. Puna shkencore e stafit akademik do të vlerësohet nga KLMSH përmes një komisioni i cili zgjedhet nga KLMSH për të vlersuar kontributin shkencor të stafit akademik. Hartimi i publikimeve shkencore do të shërbejë si bazë për avancimin ose joavancimin e stafit mësimdhënës.

1.3 KLMSH themelon komisionet shkencore të Qendrës për hulumtime shkencore dhe botime, sistemimin dhe zgjedhjen e anëtarëve, si dhe miratimin e planit të punës.

1.4 Qendra për Hulumtime Shkencore dhe botime për veprimtarinë hulumtuese dhe botuese do të përgjigjet KLMSH.

1.5 Komisioni për punë kërkimore-shkencore do të takohet tri herë në vit (qershor, tetor dhe shkurt) dhe ka këto kompetenca:

- miratojë Planin vjetor për punë kërkimore-shkencore të KU "Biznesi";
- mbikëqyrë aktivitetet e propozuara hulumtuese të çdo departamenti;
- mbikëqyrë të arriturat individuale të punës kërkimore-shkencore të stafit të KU "Biznesi".

1.6 Punimet e autorëve e materialeve i nënshtrohen recensionit nga ana e komisionit recensues i emruar nga KLMSH. Cilido emërim për rastin e recensionuesve mund të përfshijë të paktën një studiues të jashtëm ose specialist në fushën që recensionohet.

1.7 Procesi i recensionimit është anonim. KLMSH nuk duhet të zbulojë as identitetin e autorit (autorëve), as identitetin e recensionuesve, derisa ai të marrë recensionet. Po ashtu nuk duhet të zbulojë identitetin e recensionuesve para recensionuesve të tjerë.

1.8 Recensionet e punimeve shkencore i dërgohen Drejtorit të Qendrës dhe KLMSH, lidhur me materialet e paraqitura për recensionim.

1.9 Për t'u pranuar ose për të mos u pranuar punimet shkencore vlerësohen nga ana e Komisionit vlerësues, punimet e dërguara dhe jo ta aprovuara nga ana e komisionit nuk i kthehen autorëve dhe nuk mund të shfrytëzohen për qëllime tjera.

1.10 Materialet punuese përkatësisht publikimet e paraqitura sërish, duhet ta kalojnë të plotë ciklin e recensionimit. Materiale të paraqitura sërish quhen ato që janë hedhur poshtë më parë dhe pas kësaj janë rishikuar.

1.10 Përgjegjësia e parë e recensionuesve është të sigurojnë një proces korrekt dhe të efektshëm për materialet e paraqitura dhe të përcaktojnë e të mbajnë standarde të larta të cilësisë teknike dhe profesionale. Kriteret e cilësisë janë: origjinaliteti i trajtimit, konceptit dhe/ose zbatimit; thellësia dhe pesha për disiplinën në shqyrtim, si dhe respektimi i standardeve ndërkombëtare për botimin, duke përfshirë por pa u kufizuar me këtë, paraqitjen e një bibliografie kritike.

1.11 Recensentët do të bëjnë një shqyrtim të paanshëm për të gjitha materialet e paraqitura që ofrohen për t'u përdorur në KU "Biznesi" dhe do të gjykojnë secilin sipas meritave, pavarësisht nga marrëdhëniet personale ose familjarizimi me autorin (autorët), ose nga raca, gjinia, orientimi seksual, besimet fetare, origjina etnike, shtetësia, përkatësia profesionale ose filozofia politike e autori (autorëve).

1.12 Recensentët nuk do të zbulojnë asnjë informacion lidhur me materialet në diskutim para kujtdo tjetër, me përjashtim të atyre të cilëve u kërkohet këshillim profesional lidhur me botimin e dorëshkrimeve.

1.14 Nëse një recensionues paraqet dëshmi bindëse se përmbajtja, përfundimet, referimet ose një material tjetër i përfshirë në materialet që destinohen për mësim në Kolegj janë të gabuara, ai recensionues duhet të paraqesë një njoftim lidhur me çështjen te KLMSH i cili do të ndjekë procedurën e metejshme .

1.15 Nëse një recensionues paraqet dëshmi bindëse se materialet ose artikujt e botuar përmbajnë materiale plagjiat ose të dhëna kërkimore të falsifikuara, recensionuesi duhet ta paraqesë këtë dëshmi KLMSH-së.

2. Mënyra dhe kushtet për publikimin e revistës në KU "Biznesi"

Në KU "Biznesi" mund të publikohen revista periodike me punime shkencore-profesionale, katalogë, kompilacione të akteve normative, si dhe botime të tjera.

Në varësi prej llojit të publikimit, konform me legjislacionin për botimin e punimeve kërkimore-shkencore formohen këshilla, përkatësisht komisione botuese, komisione recensuese etj.

Për llojet e tjera të publikimeve dhe standardet e tyre do të respektohen dispozitat e organeve edituese të KU "Biznesi" në pajtim me këtë rregullore.

Për mbështetjen e publikimeve të përcaktuara me këtë Rregullore do të sigurohen mjete financiare të rregullta dhe ad hoc në pajtim me politikat financiare të KU "Biznesi".

2.1 Revista kërkimore-shkencore për çështje ekonomike dhe juridike "BIZNESI" e KU "Biznesi" do të publikohet dy herë në vit (çdo 6 muaj) dhe gjuha e revistës do

të jetë gjuha shqipe. Punimet të cilat do të botohen në gjuhën shqipe duhet të jenë të shoqëruara edhe me rezyme në gjuhën angleze.

2.2 Revista e KU “Biznesi” do të menaxhohet nga Qendra për hulumtime shkencore, e cila do të emërojë kryeredaktorin e kësaj reviste, Këshillin Botues dhe sekretarin e redaksisë. Sekretari duhet të ketë të kryer shkallën e magjistraturës dhe të njohë gjuhën angleze.

2.3 Natyra e punimeve të cilat do të botohen në revistën e KU “Biznesi” do të jetë e dy fushave të ndryshme:

- a) Studimi i analizës (duke përdorur pikërisht pajisje shkencore) dhe
- b) Publikimi i rezultateve hulumtuese.

2.4 Përgjegjësia e autorit (autorëve) është të:

a) sigurojë përmbledhje kuptimplota të materialeve që do të shqyrtohen në gjuhën angleze dhe shqipe,

b) sigurojë bibliografi të hollësishme,

c) dërgojë version elektronik dhe të printuar të punimit.

3. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit.

Prof. Dr. Shyqeri Kabashi

Dekan